



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: GJUHËT E HUAJA

LËNDA: FRENGJISHT

KODI: 3.2

PROGRAMI I LËNDËS FRENGJISHT PËR KLASËN E 10

TIRANË, SHTATOR 2008

Në kontekstin e sotëm social e politik ku Shqipëria aspiron të futet në Evropë dhe tendenca kryesore është krijimi i një mjedisi plurilinguist e multikulturor, gjuha e huaj ka një mision të veçantë. Ajo do të ndihmojë në shkëmbimet kulturore midis vendeve, në zhvendosjet e udhëtimet për motive të ndryshme. Programi i klasës X parashikon përvetësimin e njohurive gjuhësore e social -kulturore duke siguruar përveç mësimit të gjuhës edhe përfitim të qëndrimeve dhe sjelljeve të caktuara që inkurajojnë zhvillimin e individualitetit të nxënës/it,-es respektimin e diversitetit kulturor dhe të normave të ndryshme morale e zakonore duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimet gjuhësore në të ardhmen. Duke iu referuar nivelit të arritur deri në klasën e nëntë dhe përshkruesve të aftësive sipas *Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave* ky program synon të realizojë nivelin B1+.

Përvetësimi i gjuhës së huaj do të mundësojë integrimin gjithnjë e më të shpejtë të nxënës/it,-es shqiptar/e në një realitet të huaj si dhe një komunikim në kuptimin e mirëfilltë thjesht gjuhësor dhe më gjerë në sensin e mirëkuptimit dhe krijimit të urave midis njerëzve që jetojnë në vende dhe realitete të ndryshëm. Përdorimi i gjuhës frënge do t'i jepte nxënës/it,-es mundësinë jo vetëm të hynte në kulturën franceze, por edhe të mund të ndiqte studimet e mëtejshme në një vend tjetër të Komunitetit Evropian. Mundësitë e tij në të ardhmen për t'u punësuar gjithashtu në një vend të ndryshëm nga i veti do të ishte më e madhe. Zotërimi i mirë i gjuhës së huaj e ndihmon atë të zgjerojë dijet e tij në fusha të tjera. Kështu gjuha e huaj kthehet në një instrument për të mësuar që pasuron aftësitë konjitive. Përvetësimi i gjuhës së huaj do të ndihmonte jo vetëm pasurimin dhe lulëzimin e individualitetit të nxënës/it,-es por edhe ndërtimin e qëndrimeve dhe sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijojnë një qytetar të ri.

Programi i klasës X i gjuhës frënge sikundër edhe ata të klasave paraardhëse ka karakter tematik dhe përmban funksione të komunikimit si dhe njohuri gramatikore. Ky program synon mësimin e gjuhës nëpërmjet integritit të katër aftësive kyç (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit). Ai mban parasysh ecuinë e vitit pararendës duke rimarrë një pjesë të njohurive por me shkallë rritëse, duke shtuar dozën e vështirësisë dhe duke shtuar njohuri të reja. Kështu edhe në klasën X rimerren pothuaj të gjitha temat që nxënës/i,-ja ka marrë në klasat e tjera, pasi duke iu referuar kurrikulës kombëtare dhe udhëzimeve të *Kuadrit të Përgjithshëm Evropian të Referencave* temat duhet të përkojnë me interesat e nxënësve. Sidoqoftë rimarrja e temave bëhet nga aspekte të ndryshme dhe gjithmonë pasuruese.

Kështu përsa i përket tematikës deri tani janë studiuar në ciklet parardhëse temat mbi familjen, jetën e përditshme, shkollën, udhëtimet, festat e traditat etj; përsa i përket akteve të komunikimit nxënës/i,-ja mendohet të ketë përvetësuar njohuritë që i lejojnë të japë dhe të kërkojë informacion, të shprehë ndjenja dhe mendime, të komentojë lajme, artikuj, filma, të propozojë projekte pushimesh, etj.; në aspektin gramatikor nxënës/i,-ja ka përvetësuar tashmë struktura gramatikore që i lejojnë të përdorë disa forma të mohimit, mbiemrat pronorë, ata lidhorë, mënyrën lidhorë, foljet gjysmëndihmëse, etj. Megjithatë ai do të rimarrë një pjesë të këtyre njohurive e kompetencave që mendohet se i ka përvetësuar në formimet pararendëse.

1. SYNIMET

Në këtë fazë të formimit, qëllimi i gjuhës së huaj është të përpunojë kompetencat e fituara tashmë dhe t'i pasurojë ato në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë dhe të konsolidojë nivelin B1 e të kalojë në atë B1+ duke e aftësuar gjithnjë e më shumë këtë të fundit si një përdorues i pavarur i gjuhës dhe si një qytetar i Evropës.

Programi i gjuhës frënge për klasën e dhjetë synon që nxënës/i,-ja:

- + të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve frëngjisht-folëse dhe kulturës amtare;
- + të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme;
- + të forcojë ndërveprimin në situata reale lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore ashtu edhe jashtëshkollore;
- + të konsolidojë bashkëveprimin përmes punës në grup dhe shprehive të një pune të pavarur individuale dhe krijuese.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHME

Objektivat e përgjithshme të programit synojnë:

- të krijojnë nëpërmjet vlerësimit një profil të qartë të arritjeve gjuhësore dhe kulturore të nxënësit në fund të ciklit 9-vjeçar, për të ndërtuar mbi to aftësi të reja në gjuhën frënge duke ruajtur vazhdimësinë.
- të arrijë një formim të mirë gjuhësor në mënyrë që nxënës/i,-ja të komunikojë në situata të ndryshme, të mund të vazhdojë një ndërveprim, të realizojë shkëmbime dhe të aftësohet për të përballuar me shkathtësi probleme të përditshme në vend të huaj.
- ta edukojnë nxënësin me dashuri dhe respekt për kulturën e vendit gjuhën e të cilit mëson, me ndjenjën e solidaritetit dhe tolerancës, si qytetar të ardhshëm të një Evrope multilinguiste e multikulturore dhe që e sheh diversitetin ai pasuri kulturore.
- të nxisin nxënësin dhe mësuesin që krahas njohjes dhe pasurimit të kulturës së huaj, të forcojnë dhe ruajnë vlerat kulturore identitare
- të zhvillojnë personalitetin e nxënësit duke nxitur tek ai të mësuarit aktiv e të pavarur, mendimin kritik dhe shpirtin krijues për të përgatitur një nxënës/e që mund ta kthejë gjuhën e huaj nga objekt në një instrument të të nxënësit.

3. OBJEKTIVAT

Objektivat e programit të klasës X do të zërthehen hollësisht sipas linjave e nënlinjave dhe aftësive gjuhësore si më poshtë:

a) **Objektivat sipas standardit në komunikim**

Përshkrimi: Të gjithë nxënësit, në këtë nivel duhet të aftësohen të komunikojnë edhe për tema disi të panjohura, të argumentojnë dhe interpretojnë në frëngjisht si dhe të diskutojnë për tema dhe fakte të kulturës, vlerave dhe mentalitetit francez, me qëllim që të mund të përballojnë spontanisht në një situatë të zakonshme, të përditshme në realitetin gjuhësor e kulturor frëngjisht-folës.

Orë të sugjeruara – 85 orë

	Objektivat
<p>Kultura dhe Komunikimi.</p> <p>(60 orë)</p>	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te}, nxënës/i, -ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> + të përdorë sipas regjistrave të ndryshëm të gjuhës (zyrtare, miqësore, konfidenciale, normale, informale, etj) rregullat e mirësjelljes të popullit, gjuhën e të cilit mëson, (përdorim i nuancuar i urimeve, përshëndetjeve, fjalëve të urta, etj) + të kërkojë fjalën në publik si dhe të përdorë si duhet gjestet, pozicionin që shoqërojnë ligjërimin. + të shmangë format imperative duke i zbutur ato me kushtoren sa herë që shpreh një kërkesë; të dijë si të përdorë pasthirrat, etj + të njohë monumente të artit, personalitete, ngjarje të rëndësishme të historisë dhe të aktualitetit. + të mund të flasë për shijet e të rinjve, tregun, çmimet, modën, etj. + të njohë, kinemanë, apo këngën franceze dhe të mund të bëjë komente mbi to (të shprehë admirimin, pëlqim, mospëlqim, shije të tjera)

	Objektivat
<p>Aktet dhe funksionet e Komunikimit</p> <p>(25 orë)</p>	<p>Në përfundim të klasës së 10^{te}, nxënës/i, -ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> + Të prezantojë veten dhe të tjerët sipas situave të ndryshme, në mënyrë të nuancuar (formale, zyrtare, miqësore, etj) + Të shprehë ndjenjat (gëzim, keqardhje, zemërim...) + Të kërkojë /të japë informacion + Të komentojë një fakt (të krahasosh, të argumentosh, etj) + Të hartojë një hipotezë (ta konfirmojë, ta mohojë) + Të shkruajë një letër zyrtare (një CV, letër-kërkesë, letër motivimi, etj) + Të shprehë opinione pozitive/negative mbi diçka, mbi dikë + Të argumentojë, të bindë, të japë këshilla + Të dijë të nisë, të mbajë, të mbyllë një bisedë + Të shprehë pëlqime, shije, etj.

b) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standardit në këtë fushë aftësojnë nxënës/in,-en të prodhojë elementë gjuhësore që i përkasin nivelit B1+. Të gjithë nxënës/it,-et arrijnë një formim gjuhësor që lejon jo vetëm një komunikim të lirshëm, njohjen e strukturave gjuhësore të nevojshme, por edhe një përdorim sa më aktiv dhe pragmatik të gjuhës. Në këtë nivel bëhet rimarrja dhe përpunimi i njohurive gramatikore të përfuara si dhe integrohen struktura të reja gjuhësore, më të ndërlikuara që lejojnë një komunikim më të nuancuar. Nxënës/it,-et në këtë nivel njohin mirë sistemin gramatikor, morfologjik-sintaksor që u lejon të shprehen lirshëm, pa ose me pak gabime, me koherencë dhe me një rrjedhshmëri të mirë.

Orë të sugjeruara – 15 orë

	Objektivat
Elemente gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 10^{të}, nxënës/i,-ja aftësohet në përdorimin e:</p> <p>Elementëve morfologjikë të:</p> <ul style="list-style-type: none">• Nyjeve dhe parafjalët e ndryshme• Kohëve të përbëra (përshtatja në fjali të përbëra, imparfait- plus-que-parfait, imparfait-p.composé)• Mbiemrave dhe përemrave dëftorë, pronorë, të pakufishëm• Përemrave lidhorë• Mënyrës lidhore dhe kushtore (rimarrje)• Trajtave të shkurtra të përemrave vetorë (vendi i tyre, funksioni)• Ligjëratës së zhdrejtë• Formave pasive (rimarrje)• Përemrave y, en, vendi në fjali (rimarrje)• Ndërtimet modale me foljet gjysmëndihmëse. <p>Elementëve sintaksorë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Lidhëzat (konektorët) logjikë• Rimarrjet anaforike• Fjalitë e nënrenditura (kuptimet)• Elementë të koherencës dhe të kohezionit• Fjalive të nënrenditura – ndërtimi i tyre (kohore, qëllimore, lejore..)• Ndërtimeve e fjalive hipotetike me « si », etj

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektivat
Të dëgjuarit	<p>Nxënës/i,-ja duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ të kuptojë biseda mbi tema të njohura dhe informacion faktik ➤ të kuptojë në mënyrë globale edhe biseda me tema të panjohura me kusht që të bëhen pyetje sqaruese, ➤ të kuptojë programe televizivë dhe filma me vështirësi mesatare, të folur të qartë, debit të ngadaltë ➤ të kuptojë lajmërimet, mesazhe, slogane publicitare me gjuhë standarde.
Të lexuarit	<p>Nxënës/i,-ja duhet të jetë i aftë të kuptojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ tekste faktikë jo shumë të vështirë që lidhen me interesat e tij ➤ letra personale ku shprehen ndjenja e emocione(efekte stili) ➤ artikuj shtypi që lidhen me jetën e përditshme dhe tema të njohura ➤ tekste argumentativë të hartuar qartë dhe me koherencë ➤ udhëzime teknike ose këshilla ➤ dhe identifikojë ndarjen e tekstit në hyrje, zhvillim e konkluzione.
Të folurit	<p>Nënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ të bëjë një monolog të vazhduar ku të përshkruajë një përvojë të tij ➤ të komunikojë saktë me një kontroll të mirë gramatikor për tema të njohura ➤ të japë një intervistë me të dhëna të thjeshta ➤ të japë këshilla apo argumenta ➤ të shprehë opinione mbi tema më abstrakte si film, libra etj ➤ të reagojë dhe argumentojë lidhur me një problem, të debatojë për një temë të njohur që lidhet me aktivitetin e tij të përditshëm.
Të shkruarit	<p>Nxënës/i,-ja duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ të shkruajë letra me përshtypje mbi përvoja personale (pushime, udhëtime, etj) ➤ të shkruajë mesazhe dhe udhëzime shpjeguese për të afërmit, miqtë, etj. (zyrtare, miqësore, konfidenciale, normale, etj). ➤ të shkruajë tekste të ndryshme disi të gjatë koherente

	<p>mbi tema të njohura dhe me interes për të</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ të bëjë shkrime krijuese, përshkruese (ese) ose thjesht raportuese (raport, relacion i thjeshtë) ➤ të shkruajë tekste ku të shprehë propozime, ose të japë argumenta lidhur me një temë të caktuar ➤ të japë përshtypje dhe opinione mbi tema abstrakte (komente mbi një ngjarje, film, libër, etj) ➤ të shkruajë fundin e një tregimi të hapur, ose konkluzionet e një teksti argumentativ.
--	--

5. KERKESA NDAJ LENDEVE TE TJERA

Ashtu siç e kemi theksuar vazhdimisht, një dimension shumë i rëndësishëm i gjuhës është ai social dhe kulturor, ndaj për realizimin e këtij programi duhet mbajtur parasysh se mësimi i gjuhës shoqërohet me përvetësimin e elementëve të artit, kulturës, civilizmit etj. Nga ana tjetër nga pikëpamja e teorive konjitive duhet të theksojmë se nxënësi është bartës i një kulture dhe një vëllimi dijesh të caktuara dhe si i tillë tek ai ka një raport të ndërsjellë ku gjuha e huaj shërben si mjet për të zgjeruar njohuritë, por edhe mësohet më lehtë e pasurohet nga dijet që vijnë nga fusha të tjera. Kjo e ndërëgjegjëson mësuesin e gjuhës së huaj për një ndërveprim me mësues të lëndëve të tjera dhe domosdoshmërinë e një lidhjeje ndërëkurrikulare.

Lëndët me të cilat mund të ndërëveprojë gjuha e huaj janë:

Historia e cila me ngjarje dhe fakte të mëdha mund të ndihmojë në formimin kulturor e intelektual të nxënësit, -es njohjen e vlerave historike-shoqërore të popullit francez, personaliteteve të shquara, etj (psh, Jeanne d’Arc, Revolucioni Borgjez, 1789, Napoleoni...).

Gjeografia, njohuritë e së cilës mund të japin informacion psh për vendet turistike në Francë, duke lehtësuar kuptimin e temave mbi turizmin, zakonet turistike, kulturën e pushimeve apo të kohës së lirë, në Francë; parapëlqimet, shijet që lidhen me to, etj (psh. Stacioni i sporteve dimërore në Mont Blanc, apo plazhet në Côte d’Azur)


Filozofia, e cila mund të ndriçojë çështje të formimit intelektual e shpirtëror të francezëve, mënyrën e tyre të menduarit, kredot e mëdha, bindjet e këtij populli etj (psh Revolucioni dhe të drejtat e njeriut, vlerat morale e politike që buruan prej tij, etj.

Sociologjia, e cila mund të lehtësonte kuptimin e dokeve, zakoneve, vlerave shoqërore të një populli të huaj që kondicionohen nga një kontekst shoqëror dhe një realitet i ndryshëm nga i yni. Vetë njohja e gjuhës së huaj dhe e një kulture të huaj kultivon tek nxënësit, -ja ndjenja të tolerancës, pranimit të diversitetit etj, që lidhen ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe edukimin qytetar.

Biologjia e cila do të ndrhynte kur të trajtoheshin tema që lidhen me mjedisin, ekologjinë etj.

Ky ndërveprim sigurisht nuk është dhënë në mënyrë shterruese. Mësuesit ndërëgjegjësohet dora-dorës për këtë proces ndërëveprimi midis lëndëve sipas tematikave dhe përmbajtjes së mësimin.

Programi i klasës X do të propozonte objektiva që sipas standardeve dhe linjave nxënës/i,-ja të arrijë në të katër aftësitë përforcimin e nivelit B1 dhe arrijen deri në nivelin B1+ duke iu referuar si gjithmonë *Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës*.¹



Nxënës/i,-ja do të mund të marrë një kërkesë për informacion, të shpjegojë një vështirësi, të sjellë një informacion deri diku të saktë, të marrë pjesë në diskutime dhe të komentojë dukumentarë, lajme, të argumentojë, etj.; ai/ajo do të mund gjithashtu të zhvillojë një bisedë disi të gjatë duke pyetur bashkëbiseduesin dhe duke i kërkuar herë-pas here të përsërisë kur përgjigjet jepen me shpejtësi, të përshkruajë dhe të japë udhëzime si dhe të shkëmbejë një sasi të madhe informacionesh faktike, etj. Ky potencial që realizimi i programit parashikon do të mund të aftësojë nxënës/in,-en në orientimin e studimeve të ardhshme dhe në tregun e punës që tashmë është zgjeruar dhe i kalon kufijtë e vendit të tij. Pra, programi parashikon realizimin e synimit të kurrikulës që lidhet ***me zhvillimin e potencialit individual dhe mirëqenien e tij vetjake. (mund të futet tek integrimi)***

Këto kompetenca komunikuese kontribuojnë në rritjen e shkallës së pavarësisë së nxënës/it,-es; në zhvillimin e personalitetit të tij duke e pajisur me aftësi gjuhësore që lejojnë argumentimin, interpretimin, formulimin e hipotezave, sintezat e deduksionet duke nxitur të nxënës/i,-ja shprehitë e të menduarit kritik e krijues dhe duke realizuar kështu një nga synimet kryesore të kurrikulës kombëtare ***për zhvillimin intelektual të nxënës/it,-es.***

Aftësitë e fituara në fushat e kulturës e civilizimit, gjithmonë nëpërmjet mësimin të gjuhës ngushtojnë ndryshimet që lidhen me besimet dhe vlerat, rregullat e mirësjelljes, normat shoqërore, zakonet dhe shprehitë e jetës së përditshme, duke edukuar të nxënësit/përdorues të gjuhës ndjenjën e tolerancës dhe respektin për diversitetin e kulturave duke përgatitur kështu qytetarë të ardhshëm të një bote shumëgjuhëshe e shumëkulturore. Kështu ky program do të ndihmojë në realizimin e një tjetër synimi të kurrikulës që lidhet me qëndrimet, me ***zhvillimin etik e social*** të nxënës/it,-es i cili do të kontribuojë në të ardhmen si qytetar në zhvillimin e demokracisë në vend.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar i detyrueshëm për t’u zbatuar nga përdoruesit e tij (mësues, autorë të teksteve etj). Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

¹ *Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës* bot. MASH& KE, 2006 (f.31)

Programi lëndor është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtarë të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar në lëndën e Gjuhës Frënge dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare ashtu edhe te standardet e fushës

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentat e lartpërmenduar.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndër-kurrikulare,
- Vlerësimin të nxënës/it,-es me notë,
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtarë (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së Gjuhës Frënge për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Objektivat

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm.

Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënës/it,-et dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Shembulli më poshtë është thjesht për ilustrim:

Objektivi: “Zhvillimi i shkrimit krijues”

Kërkesa detyrës: Plotësoni tekstin e hapur sipas fantazisë suaj.

Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet të ushtrohen dhe përgatiten për realizimin e këtij objektivi. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor, gjithashtu, nëse një tekst nuk e përmban këtë njohuri, autori nuk ka respektuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës/e të ndryshëm.

Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Objektivi: “Të komentosh, të argumentosh, të plotësosh një dokument autentik mbi mjedisin ”

Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë mbi një dokument autentik.

Në një nivel të ulët mësuesi i kërkon nxënës/it,-es të dallojë paragrafët e tekstit, idenë kryesore të tij.

Në një nivel më të lartë ai u propozon një grup nxënësish të diskutojnë mbi tekstin. (të komentojnë, argumentojnë, kundërshtojnë. etj)

Në një nivel edhe më të lartë mësuesi do t'u propozonte nxënësve më të mirë të nxirrnin konkluzione me shkrim ose të japin vlersime mbi gjendjen mjedisore në Shqipëri.

Orët mësimore

Programi i gjuhës frënge për klasën e 10-të është strukturuar në linja që vijnë njera pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetorë të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur ve re se nxënës/it,-et e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënës/it,-et e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës frënge afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive(gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore

Programi i klasës së dhjetë parashikon shtrirejen e mësimit të gjuhës frënge në të gjithë vitin akademik dhe do të realizohet në 105 orë mësimore, me një frekuencë prej 3 orësh ne javë, në 35 javë mësimore (35 javë x 3 orë = 105 orë vjetore). Në këtë total përfshihen dhjetë orë të lira (mësuesi është i lirë t'i përdorë ato sipas interesave të klasës). 30% e orëve duhet të shërbejnë për përforsimin dhe përpunimin e njohurive të mara tashmë, ndërsa 70% e orëve për të krijuar te nxënës/i njohuri dhe kompetenca të reja.

Komunikimi dhe formimi kulturor në këtë nivel parashikon 85 orë, nga të cilat 60 orë i takojnë nënlinjës së *kulturës dhe komunikimit*. Në 70% orë të tyre, dmth në 42 orë, nxënës/i,-ja do të marrë aftësi sociolinguistike që nënkuptojnë funksionimin e gjuhës në dimensionin social (tregues të marrëdhënieve sociale, rregulla të mirësjelljes, shprehje të urta popullore, ndryshime të regjistrit të gjuhës, rregullat e marrjes së fjalës, etj.), ndërsa në 30% të orëve dmth në 18 orë nxënës/i,-ja do të përpunojë ose korrigjojë aftësitë e fituara pasi ai duhet të ndërjegjësohet se gabimet psh. në regjistrin e gjuhës së përdorur ose në rregullat e mirësjelljes rrezikojnë të shkaktojnë keqkuptime dhe të pengojnë komunikimin. Prandaj programi parashikon përvetësimin e këtyre aftësive nëpërmjet veprimtarive të vënies në situata, dhe kontekste të ngjashme me ato natyrale.

Realizimi i linjës së lartpërmendur me dy nënlinjat e veta nuk mund të realizohen pa linjën e dytë, **formimin gjuhësor** me 23 orë mësimore që nënkupton një strukturë gramatikore, morfo-sintaksore të caktuar që në nivelin B1+ sipas *Kuadrit të Përgjithshëm Evropian të Referencave* formulohet si më poshtë:

Nxënës/i,-ja komunikon me një korrektesë të mjaftueshme në disa kontekste familjare, ka një kontroll të mirë gramatikor pavarësisht nga ndikimet e gjuhës amtare. Mund të bëhen disa gabime, por kuptimi i përgjithshëm mbetet i qartë.

Nga totali i 23 orëve mësuesi përdor 70% dmth 16 orë për njohuritë e reja gjuhësore dhe 30% ose 7 orë mësimore për përforcimin dhe përpunimin e njohurive gjuhësore tashmë të fituara.

Këtu duhet mbajtur parasysh, sigurisht, edhe përdorimi i gjuhës nga nxënës/i,-ja pra përvetësimi i **aftësisë pragmatike** që do t'i lejojë atij ta përdorë gjuhën sipas qëllimeve të caktuara. Formimi gjuhësor gjithashtu duhet të privilegjojë aftësitë komunikative të gjuhës larg formave të mësimit tradicional të gramatikës.

Megjithatë duhet të theksojmë se ky përdorim është fleksibël dhe gjithmonë në interes të mësimdhënies/nxënies.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive-bazë të tij (konceptet themelore)
- Testimin e njohurive-bazë,
- Integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e marra,
- Integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme)
- Përsëritjen vjetore
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar)

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme si të komunikimit, menaxhimit të informacionit, zgjidhjeve problemore, të menduarit kritik dhe krijues;
- Aftësive të posaçme lëndore si komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor te ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor, etj.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta, etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe përforcuar konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Programi i klasës së 10^{të} orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës frenge në nivelin B1+.

Mësuesi është i lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/ nxënies për t'ja përshtatur nevojave të nxënësit/es në klasa të ndryshme. Ai i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijshmëri të këtij procesi.

Metodologjitë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj.

Në këtë nivel (B1+), mësuesi do të vazhdojë të adoptojë një metodologji që e konsideron gjuhën si sistem dhe për rrjedhojë, të koordinojë veprimtari që synojnë të 4 aftësitë, dmth: të punosh me kompetenca të integruara

Sidoqoftë në këtë fazë, ai mban parasysh se nxënës/i,-ja duhet të jetë një lexues i **pavarur** që në të ardhmen do të lexojë jo vetëm për kënaqësi, por edhe për qëllime të caktuara. Me qëllim që të thuhet leximi linear dhe të shmangen bllokimet në të kuptuarit e teksteve, ai mund t'i iniciojë nxënësit në **disa strategji** të të lexuarit si: leximi diagonal, leximi skremues, leximi spastrues etj. Në këtë kuadër është e rëndësishme që nxënësve t'u jepen mjete pune dhe ata vetë të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për procesin e të mësuarit. Duke mbajtur parasysh se ky proces ka dy anë pra edhe nxënien ose të mësuarit mësuesi propozon veprimtari të drejtuara ku nxënës/i,-ja vihet në situatë aktive, me qëllim që ai të mobilizojë të gjitha mjetet që zotëron për të kërkuar të dhëna, për të përqasur terma, për të ngritur hipoteza, etj.

Në këtë fazë funksioni metagjuhësor i gjuhës rritet, megjithatë mësuesi bën kujdes për të ndërhyrë me shpjegimet e duhura, që të shmangë vështirësitë dhe keqkuptimet.

Mësuesi mund të **ndryshojë funksionin e caktuar** të teksteve dhe dokumenteve.

Për një tekst të dhënë, veprimtaritë e propozuara do të ndryshojnë sipas qëllimit, pra, nëse lexojmë për kënaqësi, për një sensibilizim lidhur me përdorimin e kohëve foljore ose për të gjetur informacion.

Mësuesi në këtë fazë duhet të synojë, sigurisht, rritjen e shkallës së vështirësisë në formulimin e kërkesave të detyrave, duke u nisur nga niveli i mëparshëm, psh: ai mund të kalojë nga të **kuptuarit e përgjithshëm** (në klasat më të ulëta) shkallë –shkallë në **të kuptuarit thelbësor, të kuptuarit e saktë, të kuptuarit interpretues**, etj

Metodologjia e ndjekur nga mësuesi synon kalimin nga më e njohura te më pak e njohura, nga proceset e automatizuar tek ato krijuese.

Për sa i përket të mësuarit të gjuhës në përgjithësi, mendojmë se vetëm të kuptuarit nuk mund të çojë në mësimin e plotë të gjuhës: është krijimi ai që në fund të fundit, është vendi i praktikimit të njohurive. Sipas objektivave institucionale, shprehive dhe motivimit të nxënësve mund të vendosim marrëdhënie të ndryshme midis kuptimit dhe krijimit. Megjithatë një distancë midis tyre është gjithmonë e nevojshme, nga njëra anë, sepse kështu ndodh në gjuhën amtare (gjithmonë kuptojmë më shumë sesa mund të shprehim), nga ana tjetër, sepse të kuptuarit kërkon një organizim të të dhënave që shërben si bazë për punën gjatë krijimit. Sidoqoftë në këtë fazë, mësuesi i lë një hapësirë më të madhe **produktit me shkrim**, duke favorizuar operacionet e nivelit të lartë dhe jo vetëm proceset memorizuese, përdorimin e modeleve të gatshmen dhe të automatizuara. Kështu, mësuesi do të synojë në këtë fazë, që nxënës/i,-ja të kalojë nga **riprodhimi** i thjeshtë, (karakteristik për klasat më të ulëta) te e **shprehura më e larmishme, krijimi gjuhësor**

dhe **improvizimi**, nga e **shprehura e drejtuar** te e **shprehura vetjake**. Mësuesit, duke favorizuar në këtë klasë shkrimin i cili lejon vëzhgimin dhe ka një dimension individual, do t'i duhet të ridimensionojë vëllimin e veprimtarive me shkrim, duke i lënë më shumë vend punës individuale, sesa punës në grup.

Në këtë nivel, synohet të krijohen kushtet e përshtatshme për t'u shprehur ose për të shkruar. Është fjala për të vënë në punë gjithçka për të krijuar një klimë të përshtatshme në klasë.

Ja disa faktorë që mund të ndihmojnë: identifikimi me tjetrin, loja, humori, larmia dhe shprehësia e zërave që futen në klasë, pasuria grafike e dokumenteve të shkruar, veprimtaritë e reflektimit mbi komunikimin dhe të sensibilizimit për të folurit, teknikat e korrigjimit, zbatimi i një vlerësimi të qartë.

Në një mësimdhënie të gjuhës për qëllime komunikimi, është e domosdoshme të krijosh një motivim për të folur që të jetë sa më i justifikuar: simulim nevojash (vënie në skenë në klasë, simulime të përgjithshme, situata komunikimi të qarta), parashikim i nevojave (përdorim i gjuhës së huaj për parashikime, për qëllime të caktuara, studimi apo turizmi, për shembull), nevoja reale, brenda klasës ose që vijnë nga kontaktet jashtë klasës (punë në grupe, shfrytëzim i mjedisit, shkëmbimet midis shkollave, letërkëmbimet telematike, me internet, ose me kaseta audio ose video), por edhe kënaqësia për të luajtur, për të komunikuar, për t'u shprehur dhe për të dëgjuar tjetrin.

- Puna e diferencuar

Duke qenë se për shkak të kushteve të arsimit tonë aktual, por edhe të aftësive individuale të nxënësve, klasat tona të gjuhës së huaj kanë një publik/nxënës shumë heterogjen, mësuesi duhet të konceptojë në punën e tij edhe një dimension të punës të diferencuar, me nxënës/e të veçantë.

Një nga metodat e punës që mësuesi duhet të parapëlqejë në këto kushte është puna në grupe. Mësuesi mund të krijojë grupe mikste me nxënës/e të përparuar dhe të prapambetur; duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi këta nxënës dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që munden. Mësuesi mund t'u japë gradualisht detyra plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes që të mos rrisë vështirësitë e tyre dhe duke gjetur detyra motivuese e tërheqëse.

Mësuesi i motivon gjithashtu nxënësit e përparuar nëpërmjet veprimtarive shitesë, si përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurseshe, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj, etj. Ai mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit si integrimi lëndor, ku nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it, es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it, es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat programin lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/it,-et për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti, ndonëse matja e tyre mbetet problematike.

Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënës/it,-et dhe bashkënxënës/it,-et të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi. Duke mbajtur parasysh se vlerësimi përmban gjithmonë edhe një dimension afektiv, mësuesi mund të përdorë edhe vetëvlerësimi ose vlerësimet në grup.

Ja disa mini-veprimtari ose kërkesa për vetë-vlerësimin formues:

- të shpjegohen objektivat pedagogjike të veprimtarive;
- pas një veprimtarie të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja “Çfarë keni mësuar?”;
- t’i kërkohet rregullisht nxënësit të bëjë bilancin e njohurive të ndryshme;
- të shpallen provimet e vlerësimit përmbledhës dhe të përcaktohen paraprakisht kriteret e suksesit;
- në një situatë suksesi, të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të pasur sukses?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- pas një krijimi me shkrim, t’i kërkohet nxënësit të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (duke nënvizuar, për shembull)
- në rast mëdyshjeje mbi një formë ortografike, leksikore ose morfologjike, t’i kërkohet nxënësit ta shënojë këtë formë në tekstin e tij dhe të hartojë pyetjen në fund të faqes në formë shënimi (mësuesi i përgjigjet në të njëjtën mënyrë).

Gjithashtu mund t’i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetë-korrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta ose ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar. Në veprimtarinë e mëposhtme, do të përpiqemi të paraqesim përfytyrimet që ka nxënës/e për suksesin e një veprimtarie të dhënë.

“ Mendoni se keni pasur sukses?”

Objektivat

- Ta mësojmë nxënës/in,-en të vendosë veten në lidhje me kushtet e duhura të suksesit.
- Ta mësojmë t’i shohë krijimet e tij me sy kritik.
- Të nxjerrim në pah disa përfytyrime që ka nxënës/i,-ja për punën e tij vetjake dhe për atë që ai e quan sukses.

Ecuria

- Pas një veprimtarie krijimi ose vlerësimi, pyesim çdo nxënës/e se ç’notë ose ç’vlerësim ai (ose ajo) mendon të marrë dhe pse. Kjo pjesë e dytë e pyetjes zbulon përfytyrimet që ka nxënës/i,-ja për rezultatin e arritur dhe për raportin ndërmjet punës së tij dhe krijimit të pritur.
- Kur bëhet korrigjimi, është shumë e dobishme për nxënës/in,-en të krahasojë vlerësimin e marrë dhe vlerësimin e pritur.

Ç’notë mendoni të merrni dhe pse?

Shembuj përgjigjesh të dhëna nga nxënësit e vitit të dytë për pyetjen e mëposhtme, të bërë me shkrim pas një veprimtarie vlerësimi (klasë me 15 nxënës/e)

Disa nxënës/e i japin vetes një notë të mirë me argumentat e mëposhtëm:

- ... *sepse nuk m'u duk e vështirë*
- ... *sepse më mungonte fjalori,*
- ... *sepse i ngatërrova gjërat ,*
- ... *sepse kam vështirësi me paraafjalët*
- ... *nuk japin asnjë shpjegim*

disa nxënës/e i japin vetes notën mesatare:

- ... *sepse nuk shkoi mirë*
- ... *sepse kam vështirësi me nyjat,*
- ... *sepse nuk dita t'i përgjigjem pyetjes mbi itinerarin*

disa nxënës/e i japin vetes më pak se mesatarja:

- ... *sepse nuk shkoi mirë,*
- ... *sepse nuk kam punuar sa duhet,*
- ... *sepse nuk ia dal asnjëherë mbanë, megjithë përpjekjet*

Vërejtje

Këto rezultate tregojnë se të gjithë nxënës/it,-et nuk kanë të njëjtin perceptim për suksesin. Mund të mendojmë se ata që pohojnë “Nuk m'u duk e vështirë” dhe i japin vetes 12/20 kënaqen *a priori* me këtë rezultat, ndërsa ata që i japin vetes po këtë notë duke thënë “I ngatërrova gjërat”, ishin *a priori* më ambiciozë.

Dallime të ndjeshme ka edhe ndërmjet atyre që i japin vetes notën mesatare duke thënë: “Nuk shkoi mirë” dhe atyre që përcaktojnë shkakun e saktë të vështirësisë: “Kam vështirësi me nyjat”. Situata (pyetje e shkruar “aty për aty”) nxjerr në pah tek disa njëfarë dekurajimi i cili duhet mbajtur parasysh (duket se është rasti i përgjigjes së fundit)

Krahasimi i mëvonshëm i notës së marrë me notën, që secili i kishte vënë vetes, është tregues i mendimit që ka secili për aftësitë e tij. Me të vërtetë mund të gjejmë rastin e nxënës/it,-es që është i bindur se do të marrë notë të keqe dhe që ka dalë mirë ose rastin e atij që deklaron “M'u duk i lehtë” dhe që zbulon mangësi.

Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: recitimi, aktrimi, prodhon një krijim me shkrim (ese, poezi, etj për të konkuruar në një atelie shkrimi.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës/e në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të të nxënës. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënës, tek ato një orëshe; teste me alternative ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënës/it,-et është dhe provimi përfundimtar.

Dosja e nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, produkte të veprimtarive kurrikulare. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënës/i,-ja vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënës/it,-es. Përzgjedhjet për dosjen bëhen nga nxënës/it,-et mësuesi rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.